



VENDIM

Nr. 135 Datë 15.11.2013

PËR

SHTYRJEN E AFATIT PËR REALIZIMIN E KUSHTEVE TË VENDOSURA NGA ERE SHOQËRISË “ERS – 08 SH.P.K”

Në mbështetje të neneve 9, 13 pika 1, gërma “a”, dhe 15 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 121 dhe 128 të Ligjit Nr. 8485, datë 12.05.2008 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 15.11.2013, mbasi shqyrtoi informacionin për shtyrjen e afateve për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE shoqërisë ERS – 08 sh.p.k,

Konstatoi se:

Argumentat e shoqërisë janë të drejta dhe gjithashtu duke mbajtur në konsideratë rëndësinë e investimit dhe me qëllim mbështetjen dhe nxitjen e ndërtimit të Burimeve të Rinovueshme të Energjisë,

Vendosi:

1. Të shtyjë me 12 muaj duke filluar nga data e hyrjes ne fuqi te ketij vendimi, afatet e përcaktuara ne piken 1 (germa”a” dhe “d”) , te Vendimit Nr. 63, date 13.06.2008 "Për dhënien e Licencës shoqërisë « ERS-08 » Sh.p.k ne aktivitetin e “Ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit te centraleve elektrike me ere dhe prodhimin e energjisë elektrike nga Parku Eolik Kavajë» , i ndryshuar me Vendimin Nr. 46, date 28.05.2009 : Për një ndryshim ne Vendimin e Bordit te Komisionerëve te ERE-s Nr. 63, date 13.06.2008 ”Për dhënien e Licencës ne aktivitetin e Ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit te centraleve elektrike me ere dhe prodhimin e energjisë elektrike nga Parku Eolik Kavajë».
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit te Tregut të njoftojë shoqërinë për Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI i ERE-s

Petrit AHMETI